



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agjencia Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20 Ref.: 980/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen degët e Kolegjit UBT në Prizren dhe Ferizaj në nivel institucional për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2020 – 30 shtator 2023.
- II. Obligohet Kolegji UBT që deri me datë 1 tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit për degët në Prizren dhe Ferizaj.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji UBT ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional të degëve në Prizren dhe Ferizaj. AKA ka organizuar vlerësimin me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional. Vlerësimi për riakreditim institucional është realizuar me 15.05.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Melita Kovacevic, Magdalena Platis dhe Oana Sarbu.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit UBT për degët në Prizren dhe Ferizaj dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vlerësimit, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se degët e kolegjit UBT në Prizren dhe Ferizaj përmbushin substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se degët e Kolegjit UBT në Prizren dhe Ferizaj plotësojnë substancialisht gjashtë (6) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit; Mësimdhënia dhe të nxënit; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Burimet dhe hapësirat; Bashkëpunimi institucional), ndërsa pjesërisht plotësojnë pesë (5) (Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Menaxhimi i cilësisë; Hulumtimi; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse). Prandaj, duke u bazuar në gjetjet e ekspertëve të akreditimit si dhe në rekomandimin final të tyre për akreditim të degëve të kolegjit UBT në Prizren dhe Ferizaj, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Kontetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.